

KONTRATË SHITJE
TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË
CS AlbConsulting SHPK

Sot, më datë 23.05.2025, palët e mëposhtme:

- 1- Z. Z.Fjordi Çela, shtetas Shqiptar, lindur më 16.03.1988, lindur ne Lushnje, banues ne Durres, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr.036297317 dhe nr personal :I80316120K, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
(Ketu e mëposhtë referuar bashkërisht të tre palët si "Shitësi")

DHE

1. Z. Ervis Sina, shtetas Shqiptar, lindur më 18.09.1989, lindur ne Vlore, banues ne Durres, mbajtes i pasaportes me nr.BE5748760 dhe nr personal : I90918086I, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
(Ketu e mëposhtë referuar si "Blerësi")

Shitësi dhe Blerësi do të referohen bashkërisht si "Palët".

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë kontratë shitje të kuotave të shoqërisë me kushtet e mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE

Shitësi zotëron 50% të kapitalit që korrespondon në 1 kuote/pjesë të kapitalit me një vlerë totale prej 5.000 (Pese mijë)Lekë të shoqërisë CS AlbConsulting SHPK, me Nr. N.I.P.T: M51405512R, (këtu e mëposhtë referuar si "Shoqëria").

Neni 1
Objekti i Kontratës

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate Shitësi i transferon Blerësit me anë të shitblerjes 50% te kapitalit te barabarte me 1 kuote, me një vlerë te pergjithshme 5.000 (Pese mijë)ALL.
- 1.2 Blerësi deklaron se pranon të blejë pjesët (kuotat) e kapitalit të Shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate.



- 1.3 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 2

Çmimi i pjesëve e pagesës

- 2.1 Transferimi i pjesëve (kuotave) të kapitalit të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate nga Shitësi tek Blerësi do të kryhet përkundrejt çmimit prej 5.000 (Pese mijë)ALL.
- 2.2 Palët deklarojnë së çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate është paguar tërësisht nga Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 3

Kalimi i Pronësisë

- 3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësi bëhet titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me pjesen e tij ne kapital, përfshirë pjesëmarrjen në fitimet e Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë. Pas nenshkrimit te kesaj Kontrate, raportet e ortakeve ne shoqeri do te jene si me poshte:
- Z. Ervis Sina do te zoteroje 100 % te kapitalit te shoqerise, e barabarte me një kuote, me një vlere te per gjithshme prej 10.000 (Dhjete mijë) Leke.

Neni 4

Garancitë

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se kapitali i shoqërisë objekt të kësaj kontrate, janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.2 Shitësi deklaron se Shoqëria ka depozituar dhe paguar rregullisht dhe në kohë të gjitha tatimet, taksat, pagesa të kontributit shoqëror, kontribute të çdo lloji, zbritje apo mbajtje të çdo tipi të aplikuar në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të ardhurat, fitimet, pasuritë neto, doganat, vlerës së shtuar apo çdo referencë tjetër, në nivel kombëtar apo lokal të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 5

Forca Mëdhere



- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfardolloj dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohet për shkak të forcave madhore ose rastit fator dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucionare, çregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmbytje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qëndror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

Neni 6

Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

Neni 7

Legjislacioni i zbatueshem

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarreveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të jalin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles se Pare Tiranë Shqipëri.

Neni 9

Shpenzimet

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit do të jenë në ngarkim të Palëve.

Neni 10

Ndryshimet

- 10.1 Çdo ndryshim i përbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

Neni 11
Hyrja ne fuqi

11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

Neni 12
Gjuha e kontratës

12.1 Kontrata perpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.

PALET

SHITËSI
Z. Fjordi Çela



BLERËSI
Z. Ervis Sina

